



Njoftim për shtyp

Alpha Bank Albania – Së bashku mbështesim artin!

Në linjë me përjasjen e përgjegjësisë sociale të korporatës, Alpha Bank Albania mbështeti projektin e titulluar “Rritja dhe ndërgjegjësimi i kulturës muzeale në qytetin e Beratit”, që synon gjallërimin e trashëgimisë kulturore dhe artistike të Muzeut Onufri në Berat. Ky projekt u zhvillua në bashkëpunim me Universitetin e New York në Tiranë dhe aktorë lokalë në fushën e kulturës dhe edukimit.

Alpha Bank Albania u përfshi në krijimin dhe printimin e katalogut “Uji në arte dhe zejtari në rajonin e Beratit”, që është një përmbledhje e veprave madhore artistike që i përkasin periudhës shek. 4 para erës sonë – shek. 19 pas erës sonë.

Për më tepër, Banka mbështeti krijimin e kushteve të duhura për ekspozimin e veprave të artit, nëpërmjet përmirësimit të sistemit të ndriçimit si dhe përgatitjes së ekspozitorëve të izoluar që shërbejnë për të ruajtur kryeveprat nga kohët antike.

Pjesëmarrës në ceremonitë e organizuara ishin znj. Mirela Kumbaro, Ministre e Kulturës në Shqipëri; Prof. Assoc. Dr. Orfea Dhuci, Këshilltar Ekonomik në Alpha Bank Albania; Dr. Kosta Giakoumis, Universiteti i New York në Tiranë; z. Agron Polovina, Drejtor i Qendrës Kombëtare të Muzeve, Berat; z. Fadil Nasufi, Prefekt i Beratit etj.

Nëpërmjet këtij event, që pasuron jetën kulturore të shoqërisë shqiptare, Alpha Bank Albania theksoi edhe njëherë rëndësinë dhe vëmendjen që Banka i kushton artit dhe kulturës në Shqipëri. Alpha Bank Albania është pjesë e Grupit Alpha Bank, themeluar që prej vitit 1879 dhe është një nga bankat dhe grupet financiare kryesore në Greqi, duke i ofruar një gamë të gjerë shërbimesh, individëve, SME-ve, korporatave, nëpërmjet kartave të kreditit, drejtimit të aktiveve, veprimtarive bankare të investimit, veprimtarive bankare vetjake, veprimtarive të ndërmjetësit, leasing dhe factoring, etj. Alpha Bank është gjithashtu aktive në tregun ndërkombëtar bankar, me prani në Qipro, Rumani, Bullgari, Serbi, Shqipëri, Ish-RJ e Maqedonisë dhe Mbretërinë e Bashkuar.

